



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 29 dhjetor 2020, në mbledhjen e XXXII-të (tridhjetë e dy) mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, kati përdhes, dhe filloi në orën 10:10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti; Mehmet Gashi, Fatlume Jaha, Arlinda Kadriu, Adelinë Stublla, Vendenis Lahu, Rafet Llapashtica, Patriot Rudari, ndërsa mungoi Endritë Murati.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Marigona Lahu, Nënkyetare e Komunës, Fatlum Osmani, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, Fevzi Jetullahu, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DSHPMSH.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke iu uruar mirëseardhje, shtoi, konsideroj se thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë me kohë, ndërkohë janë sjellë edhe dy materiale për këto pika pasi që nuk kanë qenë me materiale të rendit të ditës, fjala është për Informatën financiare ku materiali është sjellë tani, pikë e cila ka hyrë në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, mirëpo siç jemi në dijeni pikat e rendit të ditës duhet të jenë të përcjella së bashku me materialet në mënyrë që qytetarët dhe këshilltarët të jenë të përgatitur, andaj edhe më është premtuar se me kohë do të sjellët materiali.

Gjithashtu ju informoj që Grupi punues i caktuar nga Kuvendi dhe anëtarët e subjekteve politike, jemi takuar dhe kemi hartuar draft propozimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2021, e kemi unifikuar dhe e kemi bërë të gatshëm, por ndërkohë nga Ekzekutivi i Komunës, përkatësisht nga Nënkyetaria e Komunës kam marrë edhe një dokument me pika shpesh për t'ju bashkangjitur këtij draft Plani të Punës për vitin 2021, material i cili besoj që tani e keni edhe ju.

Pra kjo ishte sa për informimin e juaj, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo unë do të vë në votim rendin e ditës.

z.Mehmet Gashi, theksoi, meqenëse nuk e kemi marrë me kohë gjithë materialin për rend ditë dhe drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e din që raporti financiar behet në përfundim të vitit fiskal, do të thotë më 31 dhjetor, dhe raportin 9 mujor e kemi shqyrtuar në Kuvend kurse tani pritët raportin vjetor e që duhet të jetë komplet dhe t'i kemi materialet para veti në mënyrë që ne si anëtarë të KPF-së dhe Kuvendit të jemi të informuar, e them këtë sepse ne e morëm një material tani por t'ju them të drejtën as që e shfletuam pasi nuk patëm mundësi sepse veç sa e morëm.

Në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së i rekomandoj këtij Komiteti gjegjësisht Kuvendit të Komunës, që kjo pikë të shtyhet deri në një mbledhje të radhës deri sa të kompletohen në tërësi materialet ngase këto materiale që na u shpërndanë janë raport i nxjerrë nga thesari, prandaj është mirë të kombinohet ky raport dhe të sjellët i kompletuar për tërë vitin, e që do të ishte një material i kompletuar për ne si Komiteti dhe si Kuvend.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, sa për sqarim, është shumë e vërtetë që raporti financiar është i përcaktuar edhe me planin e punës së asamblesë komunale, qoftë për vitin 2020 qoftë për 2021, rrjedhimisht raporti financiar në bazë 3 mujore dhe në fund përmbyllja e raportit financiar vjetor, nuk kemi të bëjmë me raport financiar, por me një informatë financiare ku arsyetja pse e kemi bërë këtë dhe theksi i saj është që t'i informojmë edhe asamblistët por normalisht edhe qytetarët për suficitin buxhetore, edhe pse pak a shumë kemi bërë një përmbledhje tek kjo çështje, thjesht një lloj prapësimi mes gjendjes që kemi gjetur kur ne kemi ardhur si qeverisje me 09 dhjetor 2020, cili ka qenë suficiti buxhetor, e që ka qenë afër 4,000,000.00€ vetëm prej grandit qeveritar të cilat siç jeni në dijeni kthehen në Qeveri, pastaj sa kanë arritur të shpenzohen për këtë periudhë, pse nuk kanë arrit të shpenzohen të gjitha, dhe sa ka mbetur ai suficit buxhetor, e që po t'i mbledhim të gjitha del shuma mbi 2,000.000.00€, pra më 24.12.2020 në ora 12:00 janë përmbyll pagesat dhe mjetet janë kthyer në thesar të shtetit, prandaj kjo ka qenë arsyeja që t'ju informojmë edhe juve si asamblistë por edhe qytetarët rreth kësaj situatë buxhetore, por edhe që normalisht ky suficit duhet të na shërbej edhe si mësim të gjithëve, përfshirë edhe juve si Kuvend i Komunës për monitorimin që i bëni Ekzekutivit në mënyrë që të jemi të vëmendshëm që shuma e cekur që ka mbetur suficid, për të cilën nuk po e them se ka shkuar në dëm sepse megjithatë janë kthyer në thesar të shtetit, jo diku tjetër, mirëpo sigurisht që nuk janë investime në Komunën e Podujevës e që në një formë e kemi cek se pse kanë mbet këto çështje kështu, pra në planin e asamblesë komunale nuk pash që është bërë diçka që është raport për punën e prokurimit, pastaj cili kanë qenë planifikimi i dobët i buxhetit, planifikimi i dobët i prokurimit, mos fillimi me kohë i procedurave të prokurimit, vonesa e ekzekutimit të projekteve e që ka shumë projekte që nuk kanë filluar ende procedurën e prokurimit, prandaj kjo është thjesht informatë për të cilën t'ju them të drejtën inicimi ka qenë i imi që të bëhet informatë dhe të dërgohet në Kuvend të Komunës, por sido që të jetë ne gjejmë forma të tjera të informimit të qytetarëve.

z.Vendenis Lahu, theksoi, lidhur me sqarimin që e bëri Drejtori parafolës i DBF z.Fatlum Osmani, sa e kuptova unë do të thotë se kjo që është sjellë këtu nuk është obligim ligjor, pra ju keni sjell vetëm informatë për buxhetin.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF, përgjigje parafolësit, theksoi, po është vërtetë ngase kjo është vetëm një informatë, nuk ka nevojë as të votohet në Kuvend.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, unë desha vetëm të jap një sqarim natyrisht që edhe për neve si këshilltarë të LDK-së çdo informatë është e mirëseardhur dhe mos të shihet kjo si diçka që ne nuk po duam të dëgjojmë informata të tilla, e gjithë poenta jonë ishte që është e vonuar kjo informatë sepse zakonisht edhe në të kaluarën ka pasur kritika të vazhdueshme në raste kur informata ka ardhur vonë, do të thotë fjala këtu është që mos të vazhdoj dhe të mos instalohet një sistem sipas të cilit informatat dhe materialet tjera vinë shumë vonë.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF, theksoi, çështja është kështu, buxheti dhe pagesat kanë përfunduar me datë 24 dhjetor 2020, do të thotë shumë pagesa janë ekzekutuar edhe gjatë vikendeve dhe ka qenë e pamundur të ofrohet kjo informatë më herët.

Dje e kemi pas të gatshme këtë informatë që t'jua sjellim, por pas konsultimit me zyrën ligjore na është thënë që për t'jua përcjellë asamblistëve së pari duhet të aprovohet në Komitet për Politik dhe Financa, kështu që nuk ka pasur mundësi tjetër dhe kjo informatë besoi që kish qenë shumë e dobishme për fillim

vit, faktikisht jemi në fund vit, mirëpo po e them që kjo të shërbej edhe si mësim në mënyrë që pastaj të mos jemi gjithëherë (post mortum) të vimë e të diskutojmë për 2,000,000.00€ suficit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në mbledhje të KPF-së takohemi vetëm për një qëllim, që t'i rekomandojmë apo jo pikat për mbledhjen e Kuvendit, dhe kjo është edhe kompetenca e këtij Komiteti sepse ne nuk marrim vendime. Sa i përket informatës si çështje është në rregull dhe duhet të ipet, kurse sa i përket asaj që kjo ka ardhur me vonesë, unë personalisht edhe kur ka qenë drejtori dhe pushteti paraprak asnjëherë nuk e kam votuar asnjë pikë të rendit të ditës, pra kur pika e rendit të ditës kanë ardhur ditën e mbajtjes së mbledhjes së KPF-së me përjashtim të ndonjë pike e cila nuk është varur nga personat kompetent e që ato çështje që nuk varen nga ndonjë Drejtori kompetente por varen nga vonesat e niveleve qendrore dhe që janë në interes të Komunës së Podujevës, mirëpo sa i përket kësaj pike e që drejtori i DBF e tha që është edhe vetëdijesuese për asamblastët, por jemi në dijeni se asamblastët nuk kanë qasje në shfrytëzim të buxhetit dhe të gjithë pa dallime kanë qenë kritik për suficite buxhetore, do të thotë në suficitin e 2019 edhe në këtë tani edhe në cilindo që të jetë kemi qenë dhe do jemi kritik, kemi kërkuar informatë, kemi kërkuar raport të detajuar për shfrytëzimin e parasë publike të Komunës. Pastaj rreth kësaj çështje mendoj që këto që i tha drejtori që kjo informatë po bëhet edhe për t'i njoftuar qytetarët dhe për t'i diskutuar, unë asnjëherë nuk insistoj që ta mësoj dikë në detyrën e tij që e kryen, mirëpo Ekzekutivi i Komunës ka hapësirën e plotë, qoftë të thërras konferenca për media qoftë të dal me një komunikatë dhe të tregoj se çfarë është bërë deri këtu, por lidhur me çështjen që drejtori i DBF e tha mendoj që kjo duhet të jetë në fillimvit, të mbyllen të gjitha pagesat më 31 dhjetor, mandej të gjitha borxhet ligjore që mbesin qoftë nga qiraja, borxhe tjera, fundja e kemi edhe pasqyrën e tyre financiare. Absolutisht mua nuk me pengon që kjo pikë edhe të kaloj në rend të ditës në Kuvend, por për këtë nuk mund të debatoj sepse kur debatoj për diçka dhe edhe nëse jap një kritikë dua që të jetë e bazuar dhe në rregull, ndërsa nëse ky material i nderuar Kryesues i Komitetit ka ardhur që 5-7 ditë, ju është dashur ta sillni dokumentin të paktën 3 ditë para kësaj mbledhje, madje madje në këtë Komitet me propozimin e ish asamblastit të LVV-së tani deputetit Fitim Hazirit është marr vendim dhe e kemi përkrah të gjithë që mbledhjet e KPF-së të mbahet 3 ditë para mbledhjes së Kuvendit për arsye që Grupet e subjekteve të Kuvendit të Komunës të kenë mundësi të takohen para mbledhjes së Kuvendit. Nëse kërkojmë që diçka të përfundoj në mënyrë strikte dhe ashtu qysh e kërkon legjislacioni dhe vendimmarrja atëherë duhet të jemi shumë konkret, kështu që për këtë mbledhje nuk janë njoftuar drejtorët e Drejtorive që do të mbahet sot, e as Kryetari, pastaj është dashur që materiali të sjellët me kohë e që nuk është sjellë, shembull, po e lëmë në seancën e janarit, nëse nuk mund ta lëmë në seancën e janarit e thërrasim një konferencë për media ose të bëhet deklaratë publike Zyra e Kryetarit, Drejtoria përkatëse apo Zyra për marrëdhënie me publikun dhe media. Kështu që, jo pse e keni sjellë këtë pikë i nderuar drejtor, por si anëtar i KPF-së, gjithëherë edhe kur në pushtetin e kaluar kam votuar për dhe do të votoj për çështjet kur janë në rregull proceduralisht dhe ligjërisht, por gjithëherë do të votoj kundër kur nuk janë në rregull. Sjellja në këtë formë e këtij materiali nuk është dashur të lejohet të sjellët në këtë formë, sot për sot dhe është dashur t'i tregohet drejtorit që mos të sillet, e jo të flas unë ose dikush tjetër këtu ngase pastaj po i bie si opozitarizëm i qëllimshëm, kështu që ne jemi përfaqësues normal të subjekteve politike, me mendime ndryshe por gjithëherë të bashkuar për Podujevën, prandaj unë nuk po dëshiroj ta zgjasë me shumë por e gjitha çka kisha për ta potencuar në këtë mbledhje është që ne anëtarët e KPF-së dhe Kryesuesi i Komitetit / Kuvendit, kur të vie rendi i ditës ose të bëhet ndonjë propozim të hedhet në votim kush është për, kush është kundër, dhe t'i rekomandojmë Kuvendit nëse kemi për të shtuar ose për të hequr diçka brenda rendit të ditës për arsye se kjo është kompetencë e jona që na e mundëson ligji dhe rregulloret që janë në fuqi.

Nëse më lejohet desha ta potencoj edhe një çështje që është jashtë këtij rendi të ditës por që konsideroj që është mjaft me rëndësi i nderuar Kryesues ngase tani është bërë edhe ndërrimi i pushtetit dhe

rrjedhimisht duhet të nëdërrohet edhe përbërja e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Stacioni i Autobusëve në Podujevës e që ka kërkesa nga bordi i drejtorëve të asaj ndërmarrje se është mirë të caktohet një anëtar i Komisionit të aksionarëve sepse sa kuptova ishin disa veprime që duhet të merren tash lidhur me atë ndërmarrje ku jam edhe unë në kuadër të komisionit të aksionarëve, pra e paraqita këtë çështje meqë prezent këtu është edhe Nënkrjetarja e Komunës.

Pra duhet të caktohet një anëtar nga Ekzekutivi i Komunës, mirëpo nuk e kam të qartë a duhet apo jo të kaloj në Kuvendin e Komunës, me rëndësi është që të plotësohet përbëra e komisionit të aksionarëve edhe me një anëtar nga radhët e Ekzekutivit të Komunës, sa më shpejt të jetë e mundur sepse janë disa çështje për të cilat duhet të vepohet si komision i aksionarëve.

z.Vendenis Lahu, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, pra ne diskutuam dhe debatuam rreth saj por megjithatë duhet ta bëjë një sqarim, pika që është futur në rend dite është informatë, nuk mundemi t'i bëjmë një vlerësim kritik dokumentit që na është sjellë, apo përmbajtjes që na është sjellë sot për të cilën sigurisht se nuk është përgjegjës drejtori i ri i DBF sepse ky ka dashur të raportoj domethënë për buxhetin të cilin e ka gjetur e që mendojë se ka bërë mirë që e ka sjell si pikë në rend të ditës këtë informatë për buxhetin, informatë e cila nuk votohet në Kuvend edhe pse ndoshta mund të themi se është sjellë me vonesë por nuk mendoj që është me vonesë për shkak se është informatë, janë të dhëna që ne i marrim përmes këtij dokumenti, përveç nëse drejtori ka shkruar diçka që nuk është e saktë e që besoj se nuk e ka bërë edhe nuk duhet ta bëjë, dhe nuk guxon ta bëjë, prandaj nuk e shoh problematike këtë çështje. Sigurisht që pikat e rendit të ditës të cilat janë për diskutim, por jo edhe informatat, duhet të sjellën me kohë, kurse sa i përket asaj që tha parafolësi z.Rafet Llapashtica për kritikën që i kemi bërë sidomos si LVV për sjelljen me vonesë të dokumenteve, personalisht prej se jam pjesë e KPF-së, madje në disa raste kam kërkuar që për pika të caktuara të futen në redn të ditës për senaca të Kuvendit informata nga Drejtoritë e ndryshme rreth çështjeve që kanë të bëjnë me ato Drejtori, pra ne nuk e kemi bërë shumë problematike sepse besoj që drejtorët e kanë gjendjen parasysh nëpër Drejtoritë dhe resorët të cilët i udhëheqin, andaj si informata edhe kam kërkuar të futen në rend të ditës dhe nuk shoh diçka që është shumë problematike.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, duhet t'i shikojmë dy materialet, rekomandimet apo propozimet e Kryetarit për futjen në Plan të punës së Kuvendit për vitin 2021, janë këtu në muajin mars që është raporti financiar për vitin 2020, pastaj në muaji mars 2021 po ashtu të propozuar nga Kryetari i Komunës apo Ekzekutivi, si pikë e rendit të ditës që është propozuar të futet në Plan të punës së Kuvendit, e që e keni bërë ju së bashku me shafat e Grupeve kemi dy elemente sepse për atë periudhë kohore asnjë përgjegjësi për buxhetin e vitit 2020 nuk bie mbi LVV-në sepse nuk keni qenë ekzekutues, kurse sa për të na njoftuar neve asamblastëve, shumë më pak jemi të informuar ne PDK dhe LVV sepse LDK-ja ngase këta kanë qenë aty dhe është shqyrtuar. Sa i përket informimit kombëtarë, edhe me deshtë me bë politike dhe mediale, me thënë kështu-ashtu, për ashtu unë e votoj, por nuk jam i interesuar sepse për këtë i takon subjektit opozitar në seli me dalë me thënë buxhetin e Komunës për vitin 2020 e ka qeverisur kryetari kështu e ashtu, pra ose e eliminojmë pikën e rendit të ditës për raportin financiar për vitin 2020 që është planifikuar në muajin mars 2021, andaj shtrohet pyetja tani, a jeni për ta bërë raportimin financiar për vitin 2020, apo jeni për të na dhënë informatë për vitin 2020.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, kemi të bëjmë me një çështje, raporti financiar nuk mund të eliminohet sepse është edhe obligim ligjor, është raport i tërësishëm për ecurinë e komplet vitit financiar që ka ndodh në Komunën e Podujevës, kjo po besoj që nuk do të më bie ta përsërisë, pra është informatë për buxhetin e vitit 2020, absolutisht kjo është shumë me vend që materiali duhet të shkoj më herët mirëpo nuk ka pasur mundësi sepse sot është e martë, të shtunën janë përmbyll disa pagesa, më 24 dhjetor janë përfunduar shpenzimet, certifikimet mbyllen më 26 dhjetor, pra ka qenë e shtunë, nuk ka pasur asnjë mundësi të silllet më herët, pra kjo është e vërteta, mirëpo sot nëse i dërgohet asamblastëve

është një informatë që nuk kërkon votën e asamblistëve të aprovohet apo të mos aprovohet, thjesht është informim për juve, me theks rreth mbetjes 2,000,000.00 € suficit i këtij buxheti, jam duke folur vetëm për grandin qeveritar, mjete të cilat janë kthyer, por që pastaj është shumë e rëndësishme edhe për një çështje sepse kjo do të ketë pasoja edhe në vitin 2021 ngase shumë nga mjetet të cilat janë kthyer suficid do të na kthehen në obligime në vitin 2021, e që një prej arsyeve është se ka ende kode buxhetore që nuk janë proceduar fare në prokurim si kontrata, mirëpo ka nga ata që janë tani në prokurim dhe janë në fazën e ankesave ose në fazën e vlerësimeve, do të thotë ka filluar procedura e prokurimit në tetor-nëntor dhe tani shumë kanë për të na u kthyer në obligime, mirëpo bartjet buxhetore nuk është që kanë me qenë edhe të mëdha, të atij formati, nuk është e referuar sepse ende nuk është informata për bartjen buxhetore që ka për të qenë në vitin 2021, mirëpo kjo prapë mbetet e juaja unë thjesht në atë kuptimin që kemi dashur t'i informojmë të gjithë për këtë situatë që është e pa lakmueshme.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, me që z.Rafet Llapashtica e hapi temën e planit të punës dhe këto propozimet konkrete pasi që e kemi mbajtur një takim të Grupit punues, meqenëse kam qenë anëtare aty e shoh si obligim të sqarohem, e para dua ta ceku se z.Fitim Muqolli përfaqësuesi i LVV-së atë ditë në takim ka sjell një dokument shumë konkret - dy faqesh dhe me vjen shumë mirë dhe i falënderoj të gjithë përfaqësuesit që kanë qenë aty që një frymë shumë bashkëpunuese dhe me një dakordancë të plotë e kemi bërë konturën kryesore të planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021 dhe po ju them që 90% të asaj se çka ka propozuar z.Fitim Muqolli e kemi përfshi në draft plan të punës, duke përfshirë informatat dhe gjithçka çka ka paraparë z.Fitimi Muqolli, natyrisht që ka qenë përfaqësuesi i LVV-së dhe në një formë ne kemi menduar që kur e ka sjell atë dokument ka bashkëpunuar dhe me Ekzekutivin e Komunës edhe me përfaqësuesit tjerë, me të gjithë asamblistët e LVV-së, mirëpo draft plani i punës së Kuvendit, të cilin ne e kemi përgatitur nuk do të thotë që është i pa ndryshueshëm, ne përveç planit që kemi bërë e kemi pasur dakordancën e plotë që ndërkohë nëse Ekzekutivi ka raporte financiare dhe gjëra tjera që janë të rregullta, i sjell pa marr parasysh a i përfshijmë ne në plan të punës apo jo, pra kjo nuk shihet e domosdoshme sepse kjo nuk është diçka e re që ne po e zbulojmë sepse ka ndodh edhe në qeverisjen e kaluar, sepse mua më duket çështje jo e logjikshme të mendojmë që me ndryshimin e pushtetit ndryshon shteti, domethënë ndryshojnë pushtetet, qoftë për të mirë qoftë për të keq, vazhdimësia e shtetit duhet të ekzistojë dhe natyrisht edhe të merret edhe e kaluara si kanë shkuar gjërat dhe të përmirësohen për të ardhmen, ne jemi plotësisht pro asaj, tash siç e pash z.Rafet Llapashtica e vërejtë një diçka që mund të ketë rezerva në një pikë të caktuar, shembull ka disa plane këtu shumë konkrete të cilat unë mendoj që Drejtoritë përkatëse mund t'i sjellin varësisht ku janë të përgatitur për ato pika, jo vetëm këto por edhe shumë të tjera që mund të vijnë ndërkohë, qoftë në bashkëpunime të ndryshme, qoftë gjithçka e mirë që mund të vij për Komunën e Podujevës, shembull ka disa çështje aq sa munda për pak kohë t'i shoh sepse ne nuk e kemi pasur këtë dokument më herët edhe nuk arrita t'i shoh disa çështje të cilat ne duhet të kemi një informatë pak më konkrete sepse ne nuk mund të vendosim në plan të punës, sado që plani i punës konsiderohet një dokument i thjesht, unë e llogarisë si një bazë me të cilën ne atë ditë e kemi vendos bazën me të cilën Kuvendi do të punoj me këto gjërat shtesë që mund të hyjnë ndërkohë e që janë edhe plotësisht legjitime sepse rendin e ditës e bënë Kryesuesi i Kuvendit në koordinim me Kryetarin e Komunës i cili është i pari i Ekzekutivit, shembull, janë këtu disa çështje me të cilat unë mendoj që janë konkrete dhe që mund të vijnë në seancë por që mund të mos jenë të përfshira në plan të punës siç është Harta Zonale për të cilën në takimin që kemi pasë e që ka qenë edhe përfaqësuesi i LVV-së ishte dakordimi që ajo pikë ka kaluar disa procedura ligjore, madje përfaqësuesit e LVV-së që janë në Kuvend e dinë se si ka rrjedh puna që e larguan si pikë nga rendi i ditës i mbledhjes së Kuvendit, dhe tani ka debate rreth kësaj, ne nuk e dimë a kanë vendosur ta sjellin në piken zero, si janë procedurat ligjore në këtë drejtim, janë pastaj edhe disa gjëra tjera të cilat unë mendoj që ne mund të mos i përfshijmë në plan të punës por që Ekzekutivi kurdo që është i gatshëm

mund t'i përfshijë si pika të rendit të ditës dhe ne pastaj si Kuvend jemi të obliguar që të punojmë, të votojmë kur është e nevojshme.

Po ashtu edhe një çështje tjetër çka desha ta ngris, në përgjegjësi u përmend se ka nevojë të votohet ose të mos votohet, mirëpo duhet pasur parasysh që vota është e lirë dhe ne e dimë që secili e jep votën sipas mendimeve të veta, nuk është çështja që çka do që sjellët nuk votohet edhe pse vota është kryesorja por përtej votimit ajo që është tepër e rëndësishme është se mbledhja e parë me Ekzekutivin e ri dhe kam ndjerë obligim ta them që përtej kësaj është edhe e rëndësishme që materiali të merret me kohë dhe të diskutohet sepse nuk është e rëndësishme vetëm të thuhet që kjo pikë nuk ka nevojë për votim dhe për këtë mund të sjellët një ditë para mbledhjes, andaj për ata që na kanë zgjedh neve edhe më e rëndësishme është edhe diskutimi edhe votimi për pikat e caktuara.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa për sqarim, në rend të ditës dihen pikat që janë përcaktuar, mirëpo ne jemi organ vetëm rekomandues i Kuvendit të Komunës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket dokumentit që është sjellë si kërkesë e Ekzekutivit për ta përfshirë në plan të punës së Kuvendit për vitin 2021 i cili është përgatitur nga Grupi punues i ngritur nga Kuvendi i Komunës, është bërë pa pjesëmarrjen apo propozimet e Ekzekutivit, mirëpo nëse ky dokument është plani i Ekzekutivit, ky nuk duhet të jetë asgjë, nuk dëshiroj të them diçka vetëm pse jam opozitë, por nëse mendoni të punoni në vitin 2021 me këto pika në Kuvend, mund të them se nuk është propozuar asgjë thuajse, shembull, në muajin janar vetëm një informatë për arsim nga ana e Ekzekutivit, pastaj në muajin shkurt propozim Rregullorja për bashkëpunim me fshatra, lagje dhe vendbanime urbane, bartja e mjeteve buxhetore nga vitit paraprak e që është bartje e zakonshme për çdo Ekzekutiv qoftë nga e kaluara qoftë për tani apo për të ardhmen, pastaj kemi pikën largim nga lista zonave të mbrojtjes në bazë të propozimit nëse ka, raportimi financiar, propozim për rregullore që janë dy pika që ato nuk ndryshojnë, do të thotë vetëm informatat i ka ky plan i punës, dhe tani kam një pyetje për anëtarët e KPF-së me theks të LVV-së, përse i nderuar z.Vendenis Lahu nuk keni insistuar sepse e keni më lehtë ngase ne në të kaluarën jemi ankuar si opozitë edhe në Kuvend sepse nuk na dëgjonin, pra përse nuk keni insistuar ta vendosni shembull planin e zyrës së prokurimit që është obligim ligjor, madje z.Avni Fetahu tash është edhe drejtor i DKA-së e që ka kërkuar në KPF edhe kur ka qenë në LDK që të mos ndodhin ato që po thotë drejtori, e them këtë sepse ne duhet ta shohim zyrën e prokurimit se çka punon, keni ardhur në pushtet, mirë, por unë uroj që mos të vazhdoni njëjtë, nëse vazhdoni kështu, më vie keq, por nëse nuk e ndryshoni me letra/dokumente jeni më keq se LDK sepse nuk janë sjellë dokumente të mjaftueshme dhe domethënëse në të kaluarën, letra si sasi kanë sjellë mjaftë por jo të duhurat, por që si duket ju tani edhe me letra po dilni keq. Nuk po dëshiroj të bëjë politikë mirëpo sa kohë e ka mbajtur LDK-ja njeriun e dalë në pension, në zyrën e prokurimit, prandaj meqë jemi ardhë në Kuvend dhe kemi folur për këto çështje dhe për mos sjellje të dokumenteve, bile ta dëshmoni këtë me letra, mandej subvencionet duhet t'i qesim në letër sepse në të kaluarën edhe ne si opozitë së bashku me ju që jeni tani pozitë e kemi gjykuar-kritikuar ish drejtorin dhe kemi proklamuar se po del dhe po i qet në shesh subvencionet, jo i shpërndave 10 lopë, jo i rreshtoj në shesh aty. Ne këtu përfaqësojmë qytetarët, secilin që na ka votuar dhe duke respektuar të gjithë ata që përfaqësojmë ne, e që cilët duke menduar që po bëjmë diçka për këtë vend na kanë dhënë votën, e që ne bashkërisht mund të bëjmë atë për çka jemi këtu, për interes të qytetarëve, pavarësisht mendimeve ndryshe që kemi në aspektin e politik bërjes. Po ju tregoj këtu, deri të përfundon mbledhja e fundit në tetor të vitit të kaluar, do të kërkoj planin e prokurimit. Pra e ceka se i kam dy kërkesa, meqë është edhe Nënkryetarja e Komunës këtu prezent, njëra ka të bëjë me 82,000.00€ për gjoba gjyqësore për çka kërkoj raport të detajuar dhe i njëjti të publikohet, pastaj çështja tjetër ka të bëjë me listën e pronave të uzurpuara, në fakt unë e kam një listë të pronave në fshatra që ma ka dërguar ish drejtori i Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, por kërkoj listën e pronave të uzurpuara në qytet dhe fshatra ose programin për buxhet. Nuk kam dashur ta

fusë në mbledhjen e parë, por në seancën e Kuvendit do të kërkoj nga Ekzekutivi i Komunës për këto çështje. Sa për rikujtim e juaj, afër 50 diskutime i kam pasur sa i përket problemeve me prona në Komunën e Podujevës, kështu që Nënkryetarja e Komunës është këtu prezent dhe sigurisht përfaqëson edhe Kryetarin e Komunës z.Shpejtim Bulliqin, kërkoj zyrtarisht listën e zonave dhe pronave të uzurpuar në qytet dhe fshatra (email-in tim e ka zyra ligjore dhe mund ta merrni), njëkohësisht kërkoj të të evidentohet në procesverbal kjo, në mënyrë që të më dërgohet në email si anëtar i KPF-së, pra lista e pronave të uzurpuara, ato të dhëna me qira dhe ato që janë të lira. E them këtë sepse nesër kemi për shqyrtim edhe pikën për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim, qoftë për disa prona në fshatin Batllavë dhe fshatra tjera e që ka edhe prona të uzurpuara dhe të shfrytëzuara, dhe nëse i miratojmë atëherë duhet shkuar dhe të inkasohet tatimin/taksa aty, qoftë edhe 5 cent, ashtu qysh kemi kërkuar nga ish drejtori i DPKGJ për pronat që i jepeshin KEDS-it të inkasohen tarifa sa do të ulëta për ato trafostacionet, mirëpo në fund me unanimitet pas një ankese sipas të cilës KEDS nuk paguan tarifa të tilla është dhënë prona pa pagesë.

Për të mos zgjatur më shumë, unë i votoj pikat e materialit që kanë ardhur me kohë në Kuvend, i mbështes edhe propozimet e Ekzekutivit për futjen në plan të punës të përfshira me unanimitet nga Grupi punues në të cilin ka qenë edhe përfaqësuesi i LVV-së, mirëpo këtë informatë financiare mundeni edhe me sjell dhe mirë që e ke sjell këtu e që ju falënderoj për gatishmërinë, por mendoj që së pari i nderuar Kryesues kur të sjellët tek ju duhet ta ndalni aty e të njëjtën gjë e kam thënë edhe kur ka qenë z.Mehmet Gashi Kryesues i Kuvendit. Unë e respektoj institucionin, Kryetarin e Komunës si Kryetar i Komunës time kur është me dokumente, pa dokumente nuk e njohë fare askënd, madje edhe nëse do të ishte nga subjekti im ngase dua të punoj me dokumente/letra e jo ta ulë kokën para ndokujt, pra i respektoj pozitat dhe funksionet qoftë të Kryesuesit të Kuvendi qoftë të tjerëve kushdo qoftë që vie do ta respektoj por edhe do ta kritikoj goxha fort, madje madje LVV, PDK dhe subjektet tjera që më së paku kanë arsye të “punojnë në ramje të lirë” siç e thuhet në popull.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, rendi i ditës do të miratohet me rekomandime që do i miratojmë tani, kështu që për pikën e parë ishte propozimi që t’i rekomandohet Kuvendit që të hiqet nga rendi i ditës të shtyhet për një seancë tjetër.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, i nderuar Kryesues, jo të hiqet nga rendi i ditës por të mos të futet në rend të ditës sepse edhe ashtu nuk është në rend dite fare.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, i drejtohet parafolësit, nënkuptohet kjo që të mos futet në rend dite pasi materiali ka ardhur me vonesë në KPF dhe do të shtyhet për një seancë tjetër me arsyen se është ardhur me vonesë, andaj e vë në votim, kush është që t’i rekomandohet Kuvendit që informata në fjalë të mos futet në rend dite.

1. Informatë lidhur me gjendjen financiare të Komunës së Podujevës për vitin fiskal 2020

Me 5 vota për, 2 vota kundër dhe 1 votë të përmbajtur, miratohet propozimi që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës të mbledhjes së Kuvendit, dhe e njëjta të procedohet në njërën nga mbledhjet e radhës së Kuvendit, me arsyetim që informata në fjalë nuk është dërguar me kohë në formë të shkruar, përkatësisht me thirrjen dhe materialin e mbledhjes.

2. Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2021

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar.

3. Propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e përbërjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB

4.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas propozim vendimit përkatës të dërguar me materialin e mbledhjes.

5. Propozimi i draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, informata për gjendjen në arsim e paraparë në muajin janar në planin përfundimtar të Kuvendit, mandej janë edhe një varg pikash që janë në përputhje edhe me planin e prokurimit dhe e ndërkohë është pasuruar varësisht prej rrethanave.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, po flasim për ato pika që janë të parapara në planin e punës, kurse ato që nuk janë paraparë natyrisht që propozohen të hyjnë me pikat që janë bazë, pra planin bazë të punës së Kuvendit e kemi, por i njëjti mund të pasurohet me propozimet e Grupeve të këshilltarëve që do të jepen në mbledhjen e Kuvendit apo që edhe mund të bëhen sot për rekomandim.

z.Vendenis Lahu, theksoi, ajo që dua të them fillimisht është se po vihet në dyshim dhe po e shoh një hezitim për të pranuar informata, nuk e kuptoj pse duhet të kemi hezitim, është e drejtë e secilit dhe e kuptoj këtë por nuk e mirëkuptoj përse me pas hezitim, për pikë e parë të rendit të ditës është fjala, mirëpo tani në anën tjetër Ekzekutivi në propozimet e bëra për përfshirje të pikave shtesë në draft planin e punës së Kuvendit, tani po thuhet që të mos futen në plan të punës, kjo bie në kontradiktë me të parën sepse u tha se ka ardhur vonë si material, tani mund të themi se Ekzekutivi ndonjë prej pikave veç e ka paraparë por vetëm na njofton më herët se kur ka me ardhur ajo si pikë e caktuar, dhe tani a është herët kjo që po sjellët apo ka ardhur shumë vonë.

Sa i përket pyetjes së z.Rafet Llapashtica për anëtarët e subjektit LVV, që pse nuk e keni propozuar planin e prokurimit, që e keni kërkuar, përgjigjja ime është pyetje, e pyetja është përse nuk e keni propozuar ju zotëri Llapashtica apo përfaqësuesi juaj në Grupin punues, në të njëjtën kohë unë jam i informuar që është duke u përgatitë plani punës dhe do të sjellët shume shpejt.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, sa i përket kësaj çështje unë e kuptova që këto janë veç pika shtesë të asaj që kemi punuar ne si Grup punues dhe LVV për hirë të së vërtetës e ka sjell këtë pikë, 90% e pikave që i ka sjell z.Fitim Muqolli përfaqësues i LVV në atë Grup punues janë përfshirë. Unë këtu në këtë moment kur po flasim për Planin e punës e harroj petkun politik dhe flas për frymën bashkëpunuese që e kemi pasur me përfaqësuesit e të gjitha partive politike duke e përfshirë edhe anëtarin e juaj-LVV, e ka sjell një plan, informata të bollshme të të gjitha Drejtorive, na vie mirë për këtë dhe ne i kemi përkrahë, disa i kemi modifikuar dhe çdo pikë e kemi vendosur në koordinim të plotë edhe me të tjerët që na kanë ndihmuar (asistentja e Kryesuesit dhe nga zyra ligjore) na ka ndihmuar. Pra këto që janë propozuar tani janë pika/tema shtesë, unë si anëtare mund të them se Grupi punues ka pas frymë bashkëpunuese që e kemi pasur dhe me unanimitet të plotë të të gjitha pikat i kemi përfshirë në draftin e planit të punës së Kuvendit, dhe si mesazh i përgjithshëm është që Ekzekutivi kurdo që sheh diçka të domosdoshme ta sjell në Kuvend dhe ne vazhdojmë tutje, mirëpo ka disa pika këtu që ndoshta do duhej të kemi një

shqyrtim paksa me konkret nëse do t'i vendosim apo jo sepse kjo do të ishte kontura kryesore me të cilën Kuvendi punon, pra janë disa pika të cilat unë mendoj që Ekzekutivi duhet të na sqaroj në çfarë pike në çfarë faze, në mënyrë që ne t'i përfshijmë në platformë.

Për fund unë si Fatlume, votoj për propozim planin të cilin e kemi bërë me kolegët e Grupit punues, gjithherë duke parë si mundësi dhe shtesë që Ekzekutivi të na sjell pika që janë në të mirë të kësaj Komune dhe qytetarëve në përgjithësi.

z.Vendenis Lahu, theksoi, kërkoj falje që ndoshta po merret si ndërhyrje, mirëpo a mund të na tregoni cilat janë pikat problematike për të cilat po diskutohet, ndoshta mund ta tregoni një prej pikave specifikisht dhe të na sqaroni .

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në pikën 5 të muajit qershor: Miratimi për diskutim i Hartës Zonale të Komunës, çka mendoni me këtë, kur kemi parasysh që ky diskutimi publik për Hartën Zonale ka kaluar.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pajtohem me këtë që e tha parafolësi, dokumenti i Hartës Zonale ka kaluar të gjitha fazat, Qeveria përkatësisht Ministria përkatëse e ka miratuar si dokument dhe ai ka qenë i gatshëm për tu votuar, andaj mendoj që mund të jetë vetëm për njoftim ose sensibilizim.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, debati po zhvillohet me Ekzekutivin dhe e respektoj që kanë ardhur si propozime, ne duhet të shikojmë këtu se çka po bëjmë sepse jemi anëtarë të këtij Komiteti, duhet të lexojmë se çka po shkruan këtu e jo vetëm të themi, shembull, le të hyjë / fute në plan të punës, sikurse që bën në disa raste Kuvendi i Republikës së Kosovës, ngriteni dorën të miratojmë ligje, kurse pastaj çfarë bëhet me popullin nuk na intereson, sepse pastaj qalojmë rrugës prandaj duhet ta respektojmë ligjin. Pra nëse tani futet në plan të punës së Kuvendit, duhet fillimisht të kaloj Hartën Zonale, pastaj duhet të ndryshohet, duhet të kaloj në debate publike, duhet t'i anulojmë vendimet e të gjithë asamblistëve lidhur me këtë çështje sepse aty kanë votuar edhe LVV-ja dhe të gjithë tjerët qoftë për diskutim/debat publik qoftë çështje tjera për këtë dokument.

z.Vendenis Lahu, theksoi, Hartën Zonale nuk e ndryshojmë sepse ne nuk e kemi të miratuar këtë.

z.Rafet Llapashtica, përgjigje parafolësit, theksoi, propozimi për miratim për diskutim publik, ose ka mbetur gabim teknik i shprehjes ose është bërë duke menduar që është miratuar, unë nuk jam që të mos ndryshohet ai draft se ndoshta ka pasur pika kritike edhe për Hartën Zonale, por ai dokument ashtu i përpunuar siç ka qenë, a me pëlqimin tim ose tuajin apo jo që kemi qenë kritik, ai është miratuar përkatësisht është dhënë pëlqimi në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, është mbajtur dëgjimi publik dhe është sjellë për miratim në Kuvendin e Komunës, por që pastaj siç jemi në dijeni është shtyrë për një datë/mbledhje tjetër. Tani ne jemi institucion dhe duhet të punojmë në mënyrë që të mos shkojmë në Ministri e që atje pastaj të thonë “çka janë këta analfabete që kanë hyrë këshilltarë e kanë thënë jemi më të mirët në Llap”, prandaj ta kemi të qartë se çdo vendim i miratuar duhet të shfuqizohet fillimisht e pastaj të hy e njëjta si pikë në kuadër të rendit të ditës dhe të shfuqizohen krejt ato vendime çka i kemi marr me unanimitet, apo edhe propozimet për plan të punës që janë përfshirë të gjitha në atë plan për të hyrë si pika, prandaj këtë pikë ose hiqeni ose shko thuaj Kryetarit ta ndryshojë këtë shkresën që kemi paravetës lidhur me miratimin e Hartës Zonale. E them këtë sepse po që se ne votojmë kundër pastaj po keqkuptohet dikush duke thënë po votohet kundër qoftë për materiale që sjellën herët qoftë për ato që sjellën me vonesa, si shkak.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, siç e ceku edhe znj.Fatlume Jaha, draft Planin e punës së Kuvendit e kemi punuar së bashku me 4 përfaqësuesit e 4 subjekteve politike që kemi qenë në Grup punues e kemi harmonizuar, këshilltari dhe përfaqësuesi nga radhët e LVV-së z.Fitim Muqolli, ju them se 90% baza e këtij plani që kemi para vetës ka qenë ekskluzivisht nga ato tema që i ka sjell ai dhe kjo është shumë e vërtetë, ndërsa propozimi që ka ardhur ndërkohë nga Ekzekutivi, ne mundemi të gjitha ato pika që parashihen, që janë të domosdoshme dhe të nevojshme në të mirë të qytetarëve, sigurisht që

mund të parashihen, ndërsa si bazë mund të shkoj vetëm ky draft plan dhe t'i rekomandohet për Kuvend me kusht që pikat të cilat sjellën nga Ekzekutivi e pasurojnë planin e punës së Kuvendit muaj pas muaji, kurdo që e shohim të nevojshme, pra kjo është ajo çka unë e kam kuptuar. Konkretisht mendoj se propozim Planin e punës së kuvendit për vitin 2021 që ne si Grup punues e kemi përgatitë ta rekomandojmë për seancën e Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, pra është shumë e qartë, draft plani i punës në fjalë të jetë bazë, kurse në të ardhmen, n'kuadër të rendit të ditës mund të pasurohet me pika tjera të nevojshme.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ligjërisht plani miratohet ashtu dhe i njëjti shkon në Ministrinë përkatëse, por nuk e cenzuron po që se shtojmë gjatë mbledhjeve edhe pika tjera sepse ne mund të bëjmë edhe 20 pika në një mbledhje të Kuvendit.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, gjërat janë të qarta mendoj, është përgatitur një draft plan i punës së Kuvendit dhe është sjellë për shqyrtim dhe miratim, plan i cili mund të pasurohet me pika shtesë nga Ekzekutivi i Komunës të cilat janë të mirëseardhura për qytetarët dhe institucionin, pastaj Kuvendi është ai që me vota vendos, ne vetëm e rekomandojmë.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, unë po pajtohem me sqarimin e përfaqësuesit të zyrës ligjore dhe besojmë në kompetencën e punës së tij sipas të cilës pika shtesë mund të përfshihen në seanca dhe në rekomandime, në kushte normale po, por unë personalisht kam rezervat e mia sepse siç e tha z.Rafet Llapashtica ta vendosim në diskutim publik shembull Hartën Zonale, një çështje të cilën unë në këtë moment e kam të paqartë dhe për të cilën kam pasur dakordancë të plotë në mbledhje me kolegët e mi të të gjitha subjekteve politike është Harta Zonale të cilën madje e kemi cekë si çështje të veçantë që kurdo që Ekzekutivi i Komunës e sheh të arsyeshme mund ta sjell në ndonjë mbledhje të Kuvendit, pastaj ne veprojmë sipas bindjeve tona profesionale dhe ndonjëherë edhe politike, por në përgjegjësi unë po pajtohem që mund t'i përfshijmë, mirëpo unë personalisht edhe si anëtare e atij Grupi punues do ta votoj planin të cilin e kemi bërë me kolegët, kurse pikat tjera të nevojshme që sjellën nga Ekzekutivi, siç është Harta Zonale, mund të sjellën shembull, në muajin janar 2021 nuk paraqet ndonjë problem dhe ka të drejtë, prandaj të mos i ngatërrojmë çështjet se çfarë është e drejtë çfarë nuk është. Pra unë jam për planin e punës së Kuvendit për vitin 2021, që e kemi bërë dhe proceduar ne si Grup punues i ngritur nga Kuvendi i Komunës.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, plani i punës i propozuar prej Ekzekutivit të Komunës ka ardhur tek ju me email datë 21 dhjetor 2020, domethënë me këto pika qysh i keni tani këtu para vetës janë dërguar me datën 21 dhjetor 2020, sa i përket pikave të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës dikush që po ankohet që nuk është plan i mirë dhe nuk ka shume opsione, mund të them se kjo që ju është paraqitur është njëfarë kornize bazë e Ekzekutivit se çka parashikon të procedoj për vitin 2021 në Kuvend, sigurisht të gjitha informacionet e detajuara nuk kemi por janë vetëm në mënyrë sipërfaqësore dhe që shërbejnë si parapërgatitje për muajt në vijim, e që relativisht ky plan do të del më i qartë. Kështu që mbetet të vendoset këtu sot po apo jo, mirëpo ky është propozim i Ekzekutivit të Komunës dhe sigurisht do të ketë edhe pika shtesë që realisht që ne i kemi paraparë.

z.Rafet Llapashtica, pyetje për znj.Fatlume Jaha, me cilën datë keni e përfunduar ju si Grup punues draft planin e punës së Kuvendit për vitin 2021.

znj.Fatlume Jaha, përgjigje parafolësit, theksoi, nëse nuk gaboj, një ditë para se të procedohet me thirrjen e kësaj mbledhje, respektivisht mbledhjes së Kuvendit për ditën e nesërme.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, jemi takuar dhe e kemi përgatit më shpejt këtë draft plan në mënyrë që ta përfundojmë para vitit të ri.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, si do që të jetë prapë Kuvendi merr vendim për çdo gjë se si shkon kjo çështje, si procedohet, nuk do të thotë se nuk bën të shkojë si rekomandim edhe kjo që është sjellë nga Ekzekutivi i Komunës, unë vetëm e ceka që pika për Hartën Zonale të cilën e vërejta, por që nëse vie ai

dokument në procedura është mirë ta dimë si dhe çka ngase në Kuvend ku po marram fjalën dhe po diskutojmë, siç e thoshte z.Nexhmi Rudari po bëni politikë, në fakt ne me politikë po merremi dhe nuk mund t'i ikësh kësaj çështje kur një dokument i tillë me këtë term vie për rend të ditës nga Kryetari i Komunës, ngase unë si asamblistë vendos për këto dokumente, në këtë rast për një dokument që edhe vetëvendosje ka votuar për një debat të tillë publik, dhe nëse tani i nxjerrim faktet i bie që po bëjmë politikë mirëpo nuk po dëshiroj të vie deri te ai moment andaj më mirë është të diskutojmë këtu në këtë Komitet sesa në Kuvend. Sa i përket pikave tjera për rend dite mund të sjellën nga Ekzekutivi i Komunës qoftë edhe 30 pika tjera, nuk paraqet problem ajo, dhe në të kaluarën ka ndodh. Në dokument të Ekzekutivit që e ka sjellë vetëm informata paska po thujse, përveç Hartës Zonale nuk paska diçka tjetër e që besoj që deri në fund të vitit do të zgjohen edhe subjektet politike dhe do të kërkojnë edhe informata tjera qoftë për gjendjen në shëndetësi, arsim etj.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, siç po e kuptoj nga diskutimet si përfundim po mbetet plani bazë baza që e ka punuar Grupi punues i Kuvendit me mundësi që gjatë muajve në vijim të pasurohet edhe me pika tjera në kuadër të rendit të ditës.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, për ta lënë që pikat të sjellën nga Ekzekutivi kur do që dëshiron, ajo praktikë veç ka qenë deri më tani kështu që të jemi paksa më të qartë, një plan i punës që dikush e ka kërkuar ia kemi ofruar, nëse e vlerësoni mund t'ia bashkëngjitni, nëse jo ju jeni ata që e vlerësoni dhe më mirë është të deklarojeni dhe të thoni nuk po e duam, e jo të thoni (kur t'i sjellin, kur ti dërgoni...) sepse nuk është shumë korrekte kjo, ne si Ekzekutiv e kemi sjellë si pikë Hartën Zonale, më parë e ka sjell edhe ish Ekzekutivi i Komunës për miratim e që është hequr nga rendi i ditës, nuk është bërë nami, andaj edhe ne e sjellim dhe pastaj e shohim votohet apo jo edhe kryhet puna.

Unë madje mendoj që me këtë dokument që e kemi sjellë vetëm sa na mbani për fjale neve si Ekzekutiv sikurse që na mbani për fjale edhe për informatën që po e kërkon sepse unë jam dëshmitarë që është dashur të gjenden disa rrugë alternative për me marrë një informatë që ka qenë e dobishme, dhe tani ajo po sjellët, ne po ua sjellim një plan, ju po thoni që është në interesin e opozitarizmit me pasuru me të dhëna, nëse e vlerësoni, nëse nuk e vlerësoni është kot.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket kësaj që parafolësi po e thekson rreth draft planit të punës së Kuvendit, unë vetëm e potencova që Ekzekutivi ka qenë i pa kompletuar shkaku i zgjedhjeve, por Grupi punues është dashur t' i konsultoj dalëngadalë dhe t'i përmbledhë ato çka i potencuam ne.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, për të gjitha drejtoritë e kam shpërndarë informatën që të sjellën materiale për planin e punës për vitin 2020 dhe me që është kërkuar që të mbahet një takim para vitit të ri është përshpejtuar për 3-4 ditë është tërhequr dhe këtë e din edhe kryetari edhe për material po iu them siç i kam thënë kryetari pika e parë e rendit të ditës duhet të mbulohet me material më ka thënë po do të mbulohet, dhe unë po të sqaroj që më kërkoje më herët, kryetari ka të drejt dhe unë i thash që duhet të mbulohet dhe me premtoi që ka për ta sjell e ajo mbulesa erdhi sot kështu që kush është që plani i punës që është punuar nga komisioni i kuvendit të votohet pa këto pika shtesë.

-Me 6 vota për, 2 vota kundër, Kuvendit të Komunës i rekomandohet shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021, hartuar dhe përgatitur nga Grupi punues përkatës.

-Nuk përkrahet që në kuadër të dokumentit të përfshihen edhe pikat tjera shtesë të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës.

(Bashkëngjitur këtij rekomandimi: Propozimet e pikave nga Ekzekutivi i Komunës, për përfshirje në kuadër të Planit të punës.)

- *Kryesuesi i Kuvendit, i njoftoj të pranishmit se pasi që Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve-KQZ ka bërë Certifikimin e dy anëtarëve të rijnë të Kuvendit të Komunës së Podujevës z.Bahri Blakçori dhe z.Kasib Bashota, nesër që në fillim të mbledhjes do të bëhet Dhënia e Betimit nga e tyre*

Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11;10

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0079286/20
Podujevë,
29 dhjetor 2020**

**Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Gashi**